
	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA <b>KOMUNA E RAHOVECIT</b> OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

<b>Për:</b>	Operatorë Ekonomik: <b>ITEG SH.P.K.</b> me adresë në <b>Prishtinë</b>  <b>Operatorëve Ekonomik</b>  <b>Të gjitha palëve të interesuar</b>
<b>Nga:</b>	<b>Astrit Mullabazi</b> , Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b> për Rishqyrtim të Kërkesës
<b>Datë:</b>	<b>25.05.2026</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **25.05.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **ITEG SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, nxjerr:

### VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **ITEG SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **29.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: **ITEG SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **29.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **25.05.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

### **Pretendimi nga Operatori Ekonomik Ankimor:**

Pas analizimit të detajuar të dosjes së tenderit (dokumentit në Word) si dhe të përshkrimit të çmimeve (excel format) për aktivitetin “Hartimi i projekteve të ndryshme”, kemi vërejtur se pajisjet e vendosura si kritere/kushte për ta fituar tenderin janë jashtë çdo logjike të mundshme për natyrën e këtyre shërbimeve, përveç nëse tenderi është i dedikuar vetëm për një operator të caktuar që i posedon këto pajisje.

Pajisjet e kërkuara në dosje do të ishin të kuptueshme nëse bëhej fjalë për mbikëqyrjen e punimeve kapitale të mëdha, si: tunele të gjata, rrugë të kategorisë së lartë (autostrada), ura (akuedukte apo viadukte) me hapësira të mëdha, hidrocentrale, termocentrale, apo objekte industriale të tipit të KEK-ut, etj. Ndërkaq, sipas specifikimeve të punëve të projektimit në dosje të tenderit, për Komunën e Rahovecit kërkohet që operatori ekonomik të ofrojë kryesisht shërbime të vogla/lokale, si p.sh.:

- Projekte për renovimin dhe sanimin e rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse;
- Projekte për infrastrukturë rrugore, trotuare, ndriçim publik, mure mbrojtëse, ujësjellës dhe kanalizim;
- Inçizim gjeodezik – ku në situacion të veçantë paraqitet rruga ekzistuese (skaji i rrugës, gjerësia e trotuarit në të dy anët, vija e ndërtimit të objekteve përgjatë rrugës), me gjerësi inçizimi 2x40 m nga aksi i rrugës;
- Projekte të kanalizimit dhe ujësjellësit (inçizimi i gjendjes ekzistuese të gypave, pusetave, nyjeve, pikave mbledhëse–shpërndarëse, etj.);
- Projektin e ndriçimit publik (inçizimi i gjendjes ekzistuese të rrjetit elektrik të rrymave të forta dhe të dobëta).

Në raport me këtë natyrë punësh (projektim), kriteret aktuale rezultojnë të jenë joproporcionale dhe kufizuese për konkurrencën.

Disproporcionaliteti i kërkesave aktuale

Kërkesa 3: Certifikatat ISO – “Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë);
- ISO 14001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit);
- ISO 45001:2018 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë);
- PAS 99:2012 (Sistemi i Menaxhimit të Integruar);
- ISO/IEC 27001:2013 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit).”

Arsyetim:

Pasi që është vetëm projektim, përveç ISO 9001:2015 për menaxhimin e cilësisë së projektimit, e cila mund të jetë e kuptueshme, kërkesa për të gjitha standardet e tjera ISO (veçanërisht për mjedisin, sigurinë e informacionit, sistem të integruar, etj.) nuk është e domosdoshme për natyrën e punëve projektuese të përshkuara në dosjen e tenderit.

Ekspertët e licencuar të kërkuar me dosje janë profesionistë të thirrur që t’i kryejnë detyrat e tyre projektuese me përgjegjësi dhe profesionalizëm. Kërkimi i këtij numri të madh certifikatash ISO, në një tender për shërbime të tilla projektuese lokale, krijon përshtypjen e favorizimit të një operatori të caktuar.

Kërkesa 5: Droni profesional

“Kërkohet që operatori ekonomik të ketë një (1) dron profesional për inspektim, monitorim apo rievim gjeodezik, i pajisur me kamerë digjitale me rezolucion jo më pak se 60 MP, me mundësi matjeje PPK (post processing kinematic) dhe softuerin përkatës të procesimit PPK.”

Arsyetim:

Është e kuptueshme të kërkohet një dron për inçizim gjeodezik, por vendosja e pragut minimal prej 60 MP është e tepër dhe e panevojshme për këtë lloj pune. Edhe një dron me rezolucion më të ulët, p.sh. rreth 30–40 MP, mund të sigurojë saktësi të njaftueshme, me kusht që të ulët pak lartësia e fluturimit për të arritur të njëjtën rezolucion tokësor. Diferenca këtu ka të bëjë vetëm me lartësinë e fluturimit, jo me mundësinë reale për të kryer punën. Nëse droni i kërkuar me dosje fluturon në 300m lartësi për të arritur 3cm/px, një drone me ~40MP për të njëjtën rezolucion i duhet të fluturojë me poshte në lartësi 225m’ për 3cm/px.

Kërkesa “jo më pak se 60 MP” vendos një kufizim të panevojshëm dhe mund të nënkuptojë favorizim të një operatori që posedon pikërisht këtë lloj pajisjeje.

Kërkesa 6: Pajisja gjeodezike GPS GNSS RTK – Advanced

“Kërkohet një (1) pajisje gjeodezike GPS GNSS RTK – Advanced Engine System me minimum 1408 kanale satelitore, me dual kamera në kokë–resiver, controller Handy me kamerë në terminal, me opsion rievimi 3D me fotografi (fotogrametri) dhe me laser, mundësi modelimi 3D dhe piketimi real view me kamerë.”

**Arsyetim:**

Për llojin e punëve të kërkuara (dokumentim i infrastrukturës nëntokësore dhe ajrore, koordinata e shtyllave, pushtave, gypave, etj.), një GPS gjeodezik standard dhe një total station i thjeshtë janë më se të mjaftueshëm. Edhe një GPS gjeodezik më i vjetër, me rreth 50 kanale, i gjeneron pa problem koordinatat dhe saktësinë e nevojshme dhe të njëjtë me atë që është kërkuar për këtë lloj pune. Kërkesa specifike për “Advanced Engine System me minimum 1408 kanale” është e paarsyetuar teknikisht për këtë tender dhe mund të kufizojë në mënyrë artificiale konkurrencën dhe krijon përshtypjen e favorizimit të një operatori të caktuar.

**Kërkesa 7: Total Station Robotic + GPS + Hybrid**

“Kërkohet një (1) pajisje gjeodezike Total Station Robotic + GPS + Hybrid.”

**Arsyetim:**

Për dokumentim infrastrukture, ndërtesash apo rilevim standard, një total station me saktësi p.sh. 5” është i mjaftueshëm për të arritur rezultatet e kërkuara. Kërkimi i pajisjeve të tipit Robotic + GPS + Hybrid për punë të këtij niveli është i tepruar dhe nuk justifikohet nga natyra e projekteve të parashikuara në dosje, natyrisht krijon përshtypjen e favorizimit të një operatori të caktuar.

**Kërkesa 8: Pajisja gjeodezike SLAM LiDAR 3D Scanner**

“Kërkohet një (1) pajisje gjeodezike SLAM LiDAR 3D Scanner System me RTK dhe PPK të integruar, minimum 640k pika/sekondë, me opsion 2 kamera, minimum 48 MP, me të gjitha pajisjet përcjellëse.”

**Arsyetim:**

Kjo është pajisje shumë e avancuar, e cila zakonisht përdoret për:

- dokumentim të veçantë të anomalive brenda tuneleve;
- analiza të çarjeve të konstruksioneve të urave, trupave të digave dhe mega konstruksioneve;
- inspektim të tubacioneve të mëdha (korrozion, ndryshim strukture, etj.);
- skena krimi dhe forenzikë;
- pylltari (inventarizim në zona ku GPS-i nuk funksionon për shkak të dendësisë së kurorës së pemëve), etj.

Për punët e thjeshta të infrastrukturës rrugore dhe komunale të parashikuara në këtë tender, një pajisje e tillë “high tech” është krejtësisht e paarsyetuar dhe, në praktikë, vetëm e kufizon pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë dhe krijon përshtypjen e favorizimit të një operatori të caktuar.

**Përfundim**

Kërkesat për ISO standarde që nuk lidhen drejtpërdrejt me natyrën e punëve projektuese, si dhe kërkesat për pajisje shumë të avancuara teknologjike (high tech), janë të ekzagjeruara për natyrën e punëve të përcaktuara në dosje të tenderit.

ISO standardet dhe pajisjet me specifikimet e kërkuara nuk rrjedhin nga ndonjë nevojë reale për saktësi që instrumentet standarde nuk e ofrojnë, por në praktikë rrezikojnë të kufizojnë konkurrencën, në kundërshtim me parimet e mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në këtë kuptim, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

1. Të rishqyrtojë dhe të largojë nga dosja e tenderit pajisjet dhe kriteret teknike që janë të tepruara për natyrën e punëve të tenderuara dhe që de facto favorizojnë një operator të vetëm;
2. Të thjeshtojë dhe harmonizojë specifikimet teknike me natyrën reale të shërbimeve të kërkuara, ashtu siç veprohet edhe në tenderë të ngjashëm në komuna të tjera, në mënyrë që t’u mundësohet sa më shumë operatorëve ekonomikë të konkurojnë në mënyrë të barabartë.

Kjo kërkesë bëhet për të siguruar konkurrencë të gjerë dhe të ndershme, në përputhje me parimet e prokurimit publik.

**KONKLuzion :**

Kjo bjen ndeshë me NENI 27 LPP (Dosja e Tenderi) paragrafi 1 „Autoriteti Kontraktues gjatë përpilimit të dosjes tenderit është i obliguar të përpiloj informata të qarta , dhe specifikime të zbatueshme , e jo variante për ti lënë hapsirë komisionit vlerësues të krijojë favorizimeve apo manipulime për shkak të një specifikimi jo të qartë dhe me variacione në Dosjen e tenderit dhe të njoftimi për kontratë.

## **Neni 27 Dosja e Tenderit**

1. Përveç siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni autoriteti kontraktues do të përpilojë një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termat dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutive, mundësinë e varianteve dhe informatat lidhur me nën-kontraktimin në pajtim me nenet 28, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji.

**Përpilimi i dosjes tenderit bjen ndesh edhe me NENI 28 (Specifikimet teknike)**

## **Neni 28 Specifikimet teknike**

1. Autoriteti kontraktues do të parashtrijë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtrijë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyrë sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit.

**KONKLuzion :** Ky kriter është diskriminues dhe bjen ndesh me NENI 71 LPP paragrafi 1,2, 3 dhe 4 , ( Grupët Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e huaj Ekonomik ) , pasi AK në dosjen e tenderit dhe njoftimi kontratë Operatore Ekonomik i ka përfshirë si të ndarë për plotësimin e kërkesave të dosjes tenderit e cila bjen ndeshë me NENI 66.2,68 dhe 69 të këtij ligji , pasi çdo kërkesë e vendosur nga AK do të aplikohet si tërësi ndaj grupit e jo ndaj antarëve individu

---

Përfundimisht kjo mënyrë e pregaditjes së specifikimeve teknike të aktivitetit të prokurimit është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartë cekura ku jemi të obliguar parashtrijmë ankesë parandalohet nga OSHP si organ më i lartë vendimmarrës.

---

### **Përgjigje në Pretendimi Ankimor nga AK:**

#### **Përgjigje për pretendimin ankimore nr. 1**

Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim lidhur me kriteret e certifikimeve ISO të përcaktuara në Dosjen e Tenderit për aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve të ndryshme”, Autoriteti Kontraktues e refuzon këtë pretendim si të pabazuar për arsye të vijim:

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kriteret e kërkuara në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë e shërbimeve që do të realizohen në kuadër të kontratës. Kërkesat për certifikimet ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, dhe ISO/IEC 27001:2013 janë vendosur me qëllim të garantimit të cilësisë së shërbimeve, menaxhimit efektiv organizativ, sigurisë dhe mbrojtjes së informacionit, si dhe sigurimit të standardeve profesionale gjatë realizimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha standardet e kërkuara janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë vendosur në mënyrë proporcionale, jo diskriminuese dhe në funksion të sigurimit të realizimit cilësor dhe të sigurt të kontratës.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ligjore dhe diskrecion profesional që, në përputhje me nevojat e projektit dhe kompleksitetin e shërbimeve, të përcaktojë kriteret minimale të kualifikimit që i konsideron të domosdoshme për realizimin e kontratës.

Ju sqarojmë se Operatorët Ekonomikë që ofertojnë në formë të Grupit të Operatorëve Ekonomikë (GOE), nuk obligohen që secili anëtar individualisht të posedojë të gjitha standardet ISO të kërkuara në dosjen e tenderit. Kërkesa konsiderohet e përmbushur përderisa standardet ISO të kërkuara plotësohen nga lideri i grupit ose nga anëtarët e grupit në mënyrë të përbashkët, ashtu që GOE në tërësi të përmbushë kriterin e përcaktuar në dosjen e tenderit.

Prandaj, pretendimi i operatorit ekonomik lidhur me largimin e certifikatave ISO/IEC 27001:2013, ISO 14001 dhe ISO 45001, **refuzohet si i pabazuar**.

**Ju njoftojmë se certifikata ISO PAS 99 është larguar nga dosja e tenderit.**

#### **Përgjigje për pretendimi ankimore nr. 2, 3, 4:**

Pas shqyrtimit të pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me kriteret për pajisjet teknike/gjeodezike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues e refuzon këtë pretendim si të pabazuar për arsyet në vijim:

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kërkesat minimale për pajisjet teknike dhe gjeodezike bazuar në natyrën, kompleksitetin dhe kërkesat profesionale të kontratës për hartimin e projekteve, incizimeve gjeodezike, modelimit 3D, analizave teknike dhe përgatitjes së dokumentacionit teknik.

Kërkesat për pajisje si dron profesional, GPS GNSS RTK, Total Station Robotik, SLAM LiDAR 3D Scanner të specializuara janë vendosur për të garantuar saktësi të lartë në matje, efikasitet operacional, kompatibilitet të të dhënave dhe realizim cilësor të detyrave projektuese dhe gjeodezike që parashihen në kuadër të kontratës.

Specifikimet teknike minimale të kërkuara nuk janë përcaktuar për të favorizuar ndonjë operator ekonomik apo ndonjë prodhues të caktuar, por për të siguruar standard minimal profesional dhe teknik të pajisjeve që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë parametrat minimalë teknikë që i konsideron të nevojshëm për përmbushjen e objektivave të projektit.

Sa i përket pretendimeve konkrete:

- Kërkesa për **SLAM LiDAR 3D Scanner** është vendosur për shkak të nevojës për incizim të avancuar 3D, gjenerim të modeleve precize digjitale dhe përpunim efikas të të dhënave hapësinore në terrene dhe objekte komplekse, ku kërkohet saktësi dhe shpejtësi e lartë e incizimit.

- Kërkesa për **dron profesional me kamerë minimum 60 MP** është përcaktuar për të siguruar rezolucion dhe cilësi të lartë të ortofotove, modeleve 3D dhe dokumentimit teknik vizual, të nevojshëm për projektim dhe analiza profesionale.
- Kërkesa për **GPS GNSS RTK me minimum 1408 kanale satelitore** është vendosur me qëllim të sigurimit të saktësisë së lartë në matje, stabilitetit të sinjalit dhe performancës së pajisjes në kushte të ndryshme të terrenit dhe mbulueshmërisë satelitore.
- Kërkesa për **Total Station Robotik + GPS + Hybrid** lidhet drejtpërdrejt me nevojën për integrim të metodave moderne të matjes dhe realizim efikas të punëve gjeodezike dhe projektuese në terren.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha kërkesat janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që kërkohen.

Gjithashtu, Dosja e Tenderit nuk ndalon përdorimin e pajisjeve ekuivalente (të ngjashme) profesionale, përderisa ato përmbushin parametrat minimalë teknikë dhe funksionalë të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Prandaj, pretendimi se kriteret janë diskriminuese apo të orientuara drejt operatorëve të caktuar është i pabazuar.

Theksohet se këto kërkesa **nuk janë të lidhura me marka apo prodhues të caktuar**, por janë të bazuara në performancë dhe funksionalitet. Operatorët ekonomikë mund të ofrojnë çdo pajisje ekuivalente (me performancat e specifikuara në dosjen e tenderit) ose më të avancuar që përmbush këto kërkesa minimale.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe sigurimit të konkurrencës së drejtë, duke përcaktuar vetëm ato kërkesa teknike që konsiderohen të domosdoshme për realizimin profesional dhe cilësor të kontratës.

Prandaj, kërkesa e operatorit ekonomik për ndryshimin apo largimin e kriterëve teknike për pajisjet gjeodezike refuzohet si e pabazuar.

## **PËRFUNDIM**

Pas shqyrtimit të plotë të kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga operatori ekonomik ITEG SHPK, Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha pretendimet e ngritura janë të pabazuara dhe nuk ofrojnë argumente të mjaftueshme juridike apo profesionale për ndryshimin e kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues konsideron se:

- kriteret lidhur me certifikimet ISO janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës dhe janë vendosur për të garantuar standarde profesionale, menaxhim cilësor, siguri organizative dhe mbrojtje të informacionit;

- kërkesat për softuerët profesionalë janë përcaktuar për të siguruar funksionalitetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës, duke lejuar shprehimisht edhe përdorimin e zgjidhjeve ekuivalente;
- kriteret për pajisjet teknike/gjeodezike janë vendosur mbi bazën e nevojave reale të projektit dhe synojnë garantimin e saktësisë, efikasitetit dhe cilësisë profesionale në realizimin e shërbimeve të kërkuara.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë në përputhje me objektin e kontratës, janë proporcionale, jodiskriminuese dhe të nevojshme për realizimin profesional dhe cilësor të kontratës.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik, duke siguruar trajtim të barabartë, konkurrencë të drejtë dhe transparencë në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit.

Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik **refuzohet në tërësi si e pabazuar**, ndërsa kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit mbesin të pandryshuara.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

#### **Vendimi Publikohet:**

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>